REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 1726/2 Prot.

Tiranë, më 09.11.2026

UDHËZIM[1]

Nr. 4, datë 09.11.2026

PËR PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË PRODHIMIT TË TABELAVE TË LLOGARIVE KOMBËTARE DHE PROGRAMIN E TRANSMETIMIN E METADATAVE PËRKATËSE NË KOMISIONIN EVROPIAN (EUROSTAT)

Bazuar në nenin 17, pika 4, dhe nenin 20, shkronja "b", të ligjit Nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", ligjin Nr. 30/2022 "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026", në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, miratuar me vendimin Nr. 16, datë 11.01.2024, si dhe në vendimin Nr. 24, datë 27.10.2026, të Bordit Drejtues të Institutit të Statistikave,

U D H Ë Z O J:

1. Zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 2023/734 të datës 15 Mars 2023 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 549/2013 për Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Bashkimin Evropian dhe shfuqizon 11 akte ligjore në fushën e llogarive kombëtare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor dhe strukturat e tjera përkatëse në varësi të saj për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lantona Sado

REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE TIRANË

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht Rregulloren e (BE)-së nr. 2023/734 të datës 15 Mars 2023, CELEX 32023R0734

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

I

(Akt legjislativ)

RREGULLORE
RREGULLORE (BE) 2023/734 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT

e datës 15 mars 2023

që përditëson Rregulloren (BE) Nr. 549/2013 mbi Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Bashkimin Evropian dhe që shfuqizon 11 akte ligjore në fushën e Llogarive Kombëtare

(Tekst me rëndësi për EEA)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nenin 338(1) të tij,
Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,
Pas transmetimit të projektaktit legjislativ drejt parlamenteve kombëtare,
Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane ([1]),
Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative ([2]),
Meqenëse:

(1) Rregullorja (BE) Nr. 549/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ([3]) krijoi një version të rishikuar të Sistemit Evropian të Llogarive (SLL 2010) dhe përmban kuadrin referues të standardeve, përkufizimeve, klasifikimeve dhe rregullave kontabël të përbashkëta për hartimin e llogarive të Shteteve Anëtare për qëllime të kërkesave statistikore të Bashkimit, me synim arritjen e rezultateve të krahasueshme mes Shteteve Anëtare.

(2) Shtojca A e Rregullores (BE) Nr. 549/2013 përcakton metodologjinë për hartimin e llogarive të Shteteve Anëtare.

(3) Gjatë zbatimit të Rregullores (BE) Nr. 549/2013, janë identifikuar mospërputhje të vogla teksti në Shtojcën A të asaj Rregulloreje, të cilat duhet të korrigjohen.

(4) Shtojca B e Rregullores (BE) Nr. 549/2013 ('programi i transmetimit') përcakton një sërë tabelash me të dhëna të llogarive kombëtare, përfshirë metadatat përkatëse, që Shtetet Anëtare duhet t'i transmetojnë Komisionit (Eurostat) brenda afateve të përcaktuara për qëllimet e Bashkimit Evropian

(5) Programi i transmetimit duhet të përditësohet për të marrë parasysh nevojat në ndryshim të përdoruesve, prioritetet e reja të politikave dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja ekonomike në Bashkim Evropian.[i2]

(6) Metadatat strukturore që duhet të transmetohen duhet të marrin parasysh parimet e përshkruara në Rekomandimin (BE) 2023/397 të Komisionit ([4]). Kërkesat e reja për transmetimin e metadatave nuk duhet të imponojnë kosto shtesë të tepërta apo barrë administrative të tepërt për Shtetet Anëtare.

(7) Sesioni i 49-të i Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara shqyrtoi dhe miratoi versionin e rishikuar të klasifikimit të konsumit individual sipas qëllimit (Coicop 2018) si standard të pranuar

---

[2] (1) GZ C 218, 2.6.2022, f. 2.
(2) Qëndrimi i Parlamentit Evropian i datës 2 shkurt 2023 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare) dhe vendimi i Këshillit i datës 21 shkurt 2023.
(3) Rregullorja (BE) Nr. 549/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 maj 2013 mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkimin Evropian (GZ L 174, 26.6.2013, f. 1).

ndërkombëtarisht. Rregullorja (BE) Nr. 549/2013 i referohet versionit të mëparshëm (Coicop 1999) në Shtojcat A dhe B të saj, dhe këto referenca duhet, si rrjedhojë, të përditësohen.

(8) Rregullorja (BE) Nr. 549/2013 duhet, si rrjedhojë, të ndryshohet në përputhje me sa më sipër.

(9) Meqenëse zbatimi i kësaj Rregulloreje do të kërkojë përshtatje të mëdha në sistemet statistikore kombëtare, Komisioni duhet t'u japë përjashtime të përkohshme (derogime) Shteteve Anëtare. Këto përjashtime duhet të jenë të përkohshme dhe të jepen për një kohëzgjatje maksimale prej tre vitesh. Komisioni duhet t'u ofrojë mbështetje Shteteve Anëtare të përfshira në përpjekjet e tyre për të kryer përshtatjet e nevojshme në sistemet e tyre statistikore, në mënyrë që përjashtimet të mund të ndërpriten sa më shpejt të jetë e mundur.

(10) Pas hyrjes në fuqi të Rregullores (BE) Nr. 549/2013 dhe të Rregullores (BE) 2019/516 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ([5]), 11 akte ligjore të bazuara në sistemin e mëparshëm evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale, të krijuar me Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit ([6]) (ESA 95), nuk janë më relevante. Masat e përcaktuara në këtë Rregullore do të zëvendësojnë ato të Rregulloreve (KE) Nr. 359/2002 ([7]), (KE) Nr. 1221/2002 ([8]), (KE) Nr. 1267/2003 ([9]), (KE) Nr. 501/2004 ([10]), (KE) Nr. 1161/2005 ([11]), (KE) Nr. 1392/2007 ([12]) dhe (KE) Nr. 400/2009 ([13]) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Rregullores (KE) Nr. 1222/2004 ([14]) të Këshillit, Rregullores (KE) Nr. 264/2000 ([15]) të Komisionit dhe Vendimeve të Komisionit 98/715/KE ([16]) dhe 2002/990/KE ([17]). Këto akte duhet, si rrjedhojë, të shfuqizohen.[3]

---

[3]) Rekomandimi (BE) 2023/397 i Komisionit i datës 17 shkurt 2023 mbi metadatat referuese dhe raportet e cilësisë për Sistemin Statistikor Evropian, që zëvendëson Rekomandimin 2009/498/KE mbi metadatat referuese për Sistemin Statistikor Evropian (GZ L 53, 21.2.2023, f. 104).

(5) Rregullorja (BE) 2019/516 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 mbi harmonizimin e të ardhurave kombëtare bruto me çmime tregu dhe që shfuqizon Direktivën 89/130/KEE, Euratom të Këshillit dhe Rregulloren (KE, Euratom) Nr. 1287/2003 të Këshillit (Rregullorja e TKB-së) (GZ L 91, 29.3.2019, f. 19).

(6) Rregullorja (KE) Nr. 2223/96 e Këshillit e datës 25 qershor 1996 mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkësi (GZ L 310, 30.11.1996, f. 1).

(7) Rregullorja (KE) Nr. 359/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 shkurt 2002 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit lidhur me përdorimin e SLL 95 në përcaktimin e pagesave të Shteteve Anëtare për burimin e vet të bazuar në TVSH (GZ L 58, 28.2.2002, f. 1).

(8) Rregullorja (KE) Nr. 1221/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 qershor 2002 mbi llogaritë tremujore jofinanciare të qeverisjes së përgjithshme (GZ L 179, 9.7.2002, f. 1).

(9) Rregullorja (KE) Nr. 1267/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 qershor 2003 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit lidhur me afatin e transmetimit të agregatëve kryesorë të llogarive kombëtare, me përjashtimet për transmetimin e agregatëve kryesorë të llogarive kombëtare dhe me transmetimin e të dhënave për punësimin në orë të punuara (GZ L 180, 18.7.2003, f. 1).

(10) Rregullorja (KE) Nr. 501/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 mars 2004 mbi llogaritë financiare tremujore të qeverisjes së përgjithshme (GZ L 81, 19.3.2004, f. 1).

(11) Rregullorja (KE) Nr. 1161/2005 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 korrik 2005 mbi hartimin e llogarive tremujore jofinanciare sipas sektorit institucional (GZ L 191, 22.7.2005, f. 22).

(12) Rregullorja (KE) Nr. 1392/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 nëntor 2007 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit lidhur me transmetimin e të dhënave të llogarive kombëtare (GZ L 324, 10.12.2007, f. 1).

(13) Rregullorja (KE) Nr. 400/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 prill 2009 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkësi lidhur me kompetencat zbatuese të dhëna Komisionit (GZ L 126, 21.5.2009, f. 11).

(14) Rregullorja (KE) Nr. 1222/2004 e Këshillit e datës 28 qershor 2004 mbi hartimin dhe transmetimin e të dhënave për borxhin tremujor të qeverisjes (GZ L 233, 2.7.2004, f. 1).

(15) Rregullorja (KE) Nr. 264/2000 e Komisionit e datës 3 shkurt 2000 mbi zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit lidhur me statistikat afatshkurtra të financave publike (GZ L 29, 4.2.2000, f. 4).

(16) Vendimi 98/715/KE i Komisionit i datës 30 nëntor 1998 që qartëson Shtojcën A të Rregullores (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkësi lidhur me parimet e matjes së çmimeve dhe vëllimeve (GZ L 340, 16.12.1998, f. 33).

(17) Vendimi 2002/990/KE i Komisionit i datës 17 dhjetor 2002 që qartëson më tej Shtojcën A të Rregullores (KE) Nr. 2223/96 të Këshillit lidhur me parimet e matjes së çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare (GZ L 347, 20.12.2002, f. 42).

(11) Kjo Rregullore duhet të zbatohet nga 1 shtatori 2024 për t'u përkuar me kohën e rënë dakord për rishikimet e bazës së referencës (benchmark) të harmonizuar të llogarive kombëtare në Shtetet Anëtare. Kjo nuk pengon Shtetet Anëtare të hartojnë statistikat e tyre në përputhje me Shtojcat e ndryshuara para asaj date të përgjithshme të zbatimit. Për të siguruar kohë të mjaftueshme për përshtatjen me kërkesat e reja të transmetimit, çdo detyrim i ri për të transmetuar metadata mbi informacionin strukturor duhet të zbatohet nga 1 shtatori 2025, edhe pse këto metadata mund të transmetohen vullnetarisht edhe para asaj date.

(12) Me synimin për të zbutur ndikimin social dhe ekonomik të krizës së COVID-19 dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e ekonomive dhe strukturave sociale të Shteteve Anëtare, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë nisma të mëdha, në veçanti NextGenerationEU dhe Mekanizmin për Rimëkëmbje dhe Qëndrueshmëri të krijuar me Rregulloren (BE) 2021/241 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit ([18]). Në këtë kontekst, statistikat e Bashkimit Evropian duhet të pasqyrojnë siç duhet llogaritë statistikore të institucioneve dhe organeve të BE-së. Prandaj, duhet të vazhdohet puna teknike për këtë qëllim, në mënyrë që të zhvillohet një metodologji e qëndrueshme që mundëson hartimin dhe shpërndarjen e llogarive statistikore nga Komisioni (Eurostat), përfshirë huadhënien/huamarrjen neto sipas ESA 2010 dhe detyrimet e papaguara të borxhit të Maastrihtit. Deri më 31 mars 2024, Komisioni (Eurostat) duhet t'i paraqesë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport mbi progresin e arritur në këtë drejtim.

(13) Meqenëse objektivi i kësaj Rregulloreje, është përkatësisht krijimi i standardeve të përbashkëta statistikore që mundësojnë prodhimin e të dhënave të harmonizuara të llogarive kombëtare për të arritur krahasueshmëri të përgjithshme në nivel të BE-së, nuk mund të arrihet në mënyrë të mjaftueshme nga Shtetet Anëtare, por mund të arrihet më mirë, për shkak të shkallës dhe efekteve të tij, në nivel të BE-së. Bashkimi Evropian mund të miratojë masa, në përputhje me parimin e subsidiaritetit siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit për BE-në. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, siç përcaktohet në atë nen, kjo Rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e atij objektivi.

(14) Të dhënat mbi pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit janë thelbësore për të mbështetur analizën dhe hartimin e politikave në kontekstin e politikave prioritare lidhur me digjitalizimin dhe Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, që synojnë forcimin e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të teknologjive të reja. Në mënyrë të ngjashme, të dhënat mbi tokën nën ndërtesa dhe struktura janë të rëndësishme për analizën e investimeve dhe pasurisë në nivel të BE-së. Komisioni (Eurostat) dhe autoritetet statistikore kombëtare duhet të vazhdojnë punën metodologjike të ndërmarrë në këtë fushë vitet e fundit, me synimin për të rritur disponueshmërinë e të dhënave më të detajuara në kontekstin e rishikimit të ardhshëm të sistemit evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale.

(15) Përditësime periodike janë të nevojshme për të marrë parasysh ndërveprimin mes globalizimit, tranzicioneve të gjelbra dhe digjitale dhe llogarive kombëtare, me qëllim që t'u ofrohen vendimmarrësve të dhënat dhe njohuritë e nevojshme për të siguruar konkurrueshmëri, stabilitet financiar, qëndrueshmëri buxhetore, financa publike të shëndosha dhe politikë tatimore të drejtë. Për më tepër, sesioni i 51-të i Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara i ka kërkuar tashmë Grupit të Punës Ndërsekretarial mbi Llogaritë Kombëtare të zhvillojë një udhërrëfyes për rishikimin e Sistemit të Llogarive Kombëtare 2008. Versioni i rishikuar i Sistemit të Llogarive Kombëtare planifikohet të miratohet nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara në vitin 2025.

(16) Përditësimi i manualeve ndërkombëtare mbi llogaritë kombëtare është i nevojshëm, në veçanti lidhur me mirëqenien dhe qëndrueshmërinë, duke pasur parasysh se një pjesë kaq e madhe e aktivitetit që ndikon në mirëqenien ekonomike të popullsisë ndodh përtej kufirit të prodhimit.

(17) Rishikimi i Sistemit të Llogarive Kombëtare 2008 në vitin 2025 do të japë mundësinë për të përditësuar konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe rregullat kontabël të rëna dakord ndërkombëtarisht, me synimin për t'iu përgjigjur sfidave globale lidhur me ndryshimin klimatik, sigurinë, pabarazinë, qëndrueshmërinë dhe mirëqenien, dhe do të jetë instrument në mbështetjen e vendimmarrësve për të marrë vendime të informuara për të nxitur kohezionin ekonomik, social dhe territorial, për të reduktuar pabarazitë sociale dhe gjinore dhe për të katalizuar tranzicionet e gjelbra dhe digjitale. Komisioni duhet, si rrjedhojë, të ofrojë rregullisht informacionin e nevojshëm dhe të diskutojë me Parlamentin Evropian dhe Këshillin rishikimin e Sistemit të Llogarive Kombëtare 2008 përpara përfundimit të tij, të planifikuar për vitin 2025.

(18) Komiteti i Sistemit Statistikor Evropian është konsultuar,[4]

KANË MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Ndryshime në Rregulloren (BE) Nr. 549/2013

Rregullorja (BE) Nr. 549/2013 ndryshohet si vijon:

(1) neni 6 ndryshohet si vijon:

(a) paragrafi 1 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'1. Në masën që një sistem statistikor kombëtar kërkon përshtatje të mëdha për zbatimin e Rregullores (BE) 2023/734 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*), Komisioni u jep Shteteve Anëtare përjashtime të përkohshme nëpërmjet akteve zbatuese, për një kohëzgjatje maksimale prej tre vitesh. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 8(2) të kësaj Rregulloreje.

(*) Rregullorja (BE) 2023/734 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 mars 2023 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 549/2013 mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Bashkimin Evropian dhe që shfuqizon 11 akte ligjore në fushën e llogarive kombëtare (GZ L 97, 5.4.2023, f. 1).';

(b) paragrafi 3 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'3. Për qëllimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2, Shtetet Anëtare të përfshira i paraqesin Komisionit një kërkesë të justifikuar rregullisht jo më vonë se 26 korrik 2023.';

(2) Shtojca A ndryshohet në përputhje me Shtojcën I të kësaj Rregulloreje;

(3) Shtojca B zëvendësohet me tekstin e përcaktuar në Shtojcën II të kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Shfuqizimi

[4] (18) Rregullorja (BE) 2021/241 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 shkurt 2021 që krijon Mekanizmin për Rimëkëmbje dhe Qëndrueshmëri (GZ L 57, 18.2.2021, f. 17).

Aktet ligjore të përcaktuara në Shtojcën III shfuqizohen.

Neni 3

Rishikimi

Deri më 31 mars 2024, Komisioni (Eurostat) i paraqet Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport që vlerëson progresin e arritur për sa i përket llogarive statistikore të institucioneve dhe organeve të BE-së, përfshirë huadhënien/huamarrjen neto sipas ESA 2010 dhe detyrimet e papaguara të borxhit të Maastrihtit. Në bazë të atij raporti, Komisioni mund të paraqesë, nëse është e përshtatshme, një propozim legjislativ.

Neni 4

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e njëzetë pas asaj të publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
2. Kjo Rregullore zbatohet nga 1 shtatori 2024.
3. Sipas përjashtimit (derogimit) nga paragrafi 2 i këtij Neni, neni 1, pika (3), e kësaj Rregulloreje, lidhur me detyrimin për të transmetuar metadata mbi informacionin strukturor të përmendur në paragrafin 10 të Shtojcës B të Rregullores (BE) Nr. 549/2013, zbatohet nga 1 shtatori 2025.
4 Sipas përjashtimit (derogimit) nga paragrafi 3 i këtij Neni, detyrimi për të transmetuar metadata mbi informacionin strukturor të përmendur në paragrafin 10 të Shtojcës B të Rregullores (BE) Nr. 549/2013, lidhur me tabelën 27 të asaj Shtojce, zbatohet nga 1 shtatori 2024.

Kjo Rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe zbatohet drejtpërdrejt në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 15 mars 2023.

Për Parlamentin Evropian
Presidentja

R. METSOLA

Për Këshillin
Presidenti

J. ROSWALL

SHTOJCA I

Shtojca A e Rregullores (BE) Nr. 549/2013 ndryshohet si vijon:

(1) në paragrafin 1.51, pika (b) zëvendësohet me tekstin si vijon:
(b) shpenzimet për sistemet e armëve që plotësojnë përkufizimin e përgjithshëm të aktiveve janë klasifikuar si formim bruto i kapitalit fiks, dhe jo si konsum i ndërmjetëm;';

(2) në paragrafin 1.51, pika (h) zëvendësohet me tekstin si vijon:
(h) trajtimi i super-dividendëve të paguar nga korporatat publike është qartësuar, d.m.th. ato konsiderohen si pagesa të jashtëzakonshme dhe trajtohen si tërheqje nga kapitali (equity);';

(3) në paragrafin 1.118, titulli i diagramit zëvendësohet me tekstin si vijon:
'Diagrami 1.1 - Diagram i sekuencës së llogarive';

(4) në paragrafin 3.98, teksti hyrës zëvendësohet me tekstin si vijon:
'Shpenzimet për konsum final (P.3) nga qeverisja e përgjithshme përfshijnë dy kategori, të ngjashme me ato të regjistruara për NPISH-të:';

(5) paragrafi 3.105 zëvendësohet me tekstin si vijon:
'3.105 Në mënyrë alternative, shpenzimi për konsum individual i qeverisjes së përgjithshme korrespondon me divizionin 15 të klasifikimit të konsumit individual sipas qëllimit (Coicop), i cili përfshin grupet si vijon:
15.1 Strehimi (ekuivalente me grupin 10.6 të COFOG)
15.2 Shëndetësia (ekuivalente me grupet 7.1 deri 7.4 të COFOG)
15.3 Argëtimi dhe kultura (ekuivalente me grupet 8.1 dhe 8.2 të COFOG)
15.4 Arsimi (ekuivalente me grupet 9.1 deri 9.6 të COFOG)
15.5 Mbrojtja sociale (ekuivalente me grupet 10.1 deri 10.5 dhe grupin 10.7 të COFOG).';

(6) paragrafi 3.124 zëvendësohet me tekstin si vijon:
'3.124 Përkufizimi: formimi bruto i kapitalit fiks (P.51g) përbëhet nga blerjet, minus disponimet, e aktiveve fikse nga prodhues rezidentë gjatë një periudhe të caktuar, plus disa shtesa në vlerën e aktiveve jo të prodhuara të realizuara nëpërmjet aktivitetit prodhues të njësisë prodhuese ose institucionale. Aktivet fikse janë aktive të prodhuara që përdoren në prodhim për më shumë se një vit.';

(7) në paragrafin 3.132, pika (c) zëvendësohet me tekstin si vijon:
(c) softuer kompjuterik dhe baza të dhënash që do të përdoren në prodhim për më shumë se një vit;';

(8) paragrafi 3.138 zëvendësohet me tekstin si vijon:
'3.138 Kostot e transferimit të pronësisë mund të zbatohen si për aktivet e prodhuara, përfshirë aktivet fikse, ashtu edhe për aktivet jo të prodhuara, si p.sh. toka.
Këto kosto përfshihen në çmimet e blerësit në rastin e aktiveve të prodhuara. Ato ndahen nga vetë blerjet dhe shitjet në rastin e tokës dhe aktiveve të tjera jo të prodhuara, dhe regjistrohen nën një zë të veçantë (P.512) në klasifikimin e formimit bruto të kapitalit fiks.';

(9) në paragrafin 3.181, fjalia e fundit zëvendësohet me tekstin si vijon:
'Transferimi i mallrave ekzistuese regjistrohet si shpenzim negativ (disponim) për shitësin dhe si shpenzim pozitiv (blerje) për blerësin.';

(10) në paragrafin 4.40, fjalia e tretë fshihet;

(11) paragrafi 4.50 zëvendësohet me tekstin si vijon:
'4.50 Interesi regjistrohet mbi bazën e përllogaritjes (accrual), pra interesi regjistrohet si i përllogaritur vazhdimisht me kohën për kreditorin mbi shumën e principalit të papaguar. Interesi i përllogaritur në çdo periudhë kontabël duhet të regjistrohet pavarësisht nëse është paguar realisht apo shtuar te principali i papaguar. Kur nuk paguhet, rritja e principalit regjistrohet në llogarinë financiare si blerje e një aktivi financiar nga kreditori dhe si blerje e barasvlershme e një detyrimi nga debitori.';

(12) në paragrafin 4.82, teksti 'Në disa raste, detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat mund të përcaktohet vetëm në një periudhë kontabël të mëvonshme se ajo në të cilën përllogaritet e ardhura. Prandaj nevojitet një farë fleksibiliteti lidhur me momentin kohor kur regjistrohen këto tatime. Tatimet mbi të ardhurat e mbajtura në burim, si tatimet PAYE dhe parapagimet e rregullta të tatimit mbi të ardhurat, mund të regjistrohen në periudhat kur paguhen dhe çdo detyrim tatimor final mbi të ardhurat mund të regjistrohet në periudhën kur përcaktohet detyrimi.' zëvendësohet me tekstin si vijon:

'Në disa raste, detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat mund të përcaktohet vetëm në një periudhë kontabël të mëvonshme se ajo në të cilën përllogaritet e ardhura. Prandaj nevojitet një farë fleksibiliteti lidhur me momentin kohor kur regjistrohen këto tatime. Tatimet mbi të ardhurat e mbajtura në burim, si tatimet 'pay-as-you-earn' (PAYE) dhe parapagimet e rregullta të tatimit mbi të ardhurat, mund të regjistrohen në periudhat kur paguhen dhe çdo detyrim tatimor final mbi të ardhurat mund të regjistrohet në periudhën kur përcaktohet detyrimi.';

(13) në paragrafin 4.93, pika (a) zëvendësohet me tekstin si vijon:

(a) kontributet shoqërore të paguara nga persona që nuk janë të detyruar ligjërisht të kontribuojnë në një fond të sigurimeve shoqërore;';

(14) paragrafi 5.235 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'5.235 FISIM-i i përllogaritur por ende i papaguar përfshihet me instrumentin financiar përkatës dhe parapagimi i primeve të sigurimit përfshihet në rezervat teknike të sigurimit (F.61); në asnjë nga rastet nuk ka zë në kreditë tregtare dhe paradhëniet.';

(15) në paragrafin 5.236, pika (c) zëvendësohet me tekstin si vijon:

(c) qiraja e ndërtesave e përllogaritur me kohën; dhe';

(16) paragrafi 7.88 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'7.88 Vlera e tregut e kontratave të ardhme (forwards) mund të kalojë mes pozicioneve pozitive (aktiv) dhe negative (detyrim) në varësi të lëvizjeve të çmimit të zërave bazë, dhe kështu ato mund të kalojnë nga aktive në detyrime për shkruesit dhe mbajtësit. Disa kontrata të ardhshme funksionojnë me pagesa marzhi, ku fitimet ose humbjet shlyhen çdo ditë; në këto raste vlera në bilanc do të jetë zero.';

(17) në paragrafin 8.09, tabela 8.1 zëvendësohet me tekstin si vijon:

Tabela 8.1

Paraqitja sinoptike e llogarive, zërave baraspeshues dhe agregatëve kryesorë

Sekuenca e plotë e llogarive për sektorët institucionalë

Grupi	Llogaria	Nën-llogaria	Nën-nën-llogaria	Zëri baraspeshues	Agregati kryesor
Llogaritë rjedhëse	I. Llogaria e prodhimit	I. Llogaria e prodhimit		B.1g Vlera e shtuar, bruto	Produkti i brendshëm bruto (PBB)
	II. Llogaritë e shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave	II.1 Llogaritë e shpërndarjes primare të të ardhurave	II.1.1 Llogaria e krijimit të të ardhurave	B.2g Tepricë veprimtarie, bruto B.3g Të ardhura të përziera, bruto	
			II.1.2 Llogaria e ndarjes së të ardhurës primare		
			II.1.2.1 Llogaria e të ardhurave sipërmarrëse	B.4g Të ardhura sipërmarrëse, bruto	
			II.1.2.2 Llogaria e ndarjes së të ardhurave të tjera primare	B.5g Bilanci i të ardhurave primare, bruto	Të ardhurat kombëtare bruto (TKB)
		II.2 Llogaria e shpërndarjes sekondare të të ardhurave		B.6g Të ardhura të disponueshme, bruto	Të ardhura kombëtare bruto të disponueshme
		II.3 Llogaria e rishpërndarjes së të ardhurave në natyrë		B.7g Të ardhura të disponueshme të rregulluara, bruto	

Grupi	Llogaria	Nën-llogaria	Nën-nën-llogaria	Zëri baraspeshues	Agregati kryesor
		II.4 Llogaria e përdorimit të të ardhurave	II.4.1 Llogaria e përdorimit të të ardhurave të disponueshme	B.8g Kursim, bruto	Kursim kombëtar bruto
			II.4.2 Llogaria e përdorimit të të ardhurave të disponueshme të rregulluara		
Llogaritë e akumulimit	III. Llogaritë e akumulimit	III.1 Llogaria e kapitalit	III.1.1 Llogaria e ndryshimit të vlerës neto për shkak të kursimit dhe transfertave kapitale	B.101 Ndryshimi i vlerës neto për shkak të kursimit dhe transfertave kapitale	
			III.1.2 Llogaria e blerjes së aktiveve jofinanciare	B.9 Huadhënie/huamarrje neto	
		III.2 Llogaria financiare		B.9F Huadhënie/huamarrje neto	
		III.3 Llogaria e ndryshimeve të tjera në aktive	III.3.1 Llogaria e ndryshimeve të tjera në vëllimin e aktiveve	B.102 Ndryshimet e vlerës neto, për shkak të ndryshimeve të tjera në vëllimin e aktiveve	
			III.3.2 Llogaritë e rivlerësimit		
			III.3.2.1 Llogaria e fitimeve/humbjeve neutrale nga mbajtja	B.1031 Ndryshimet e vlerës neto për shkak të fitimeve/humbjeve neutrale nga mbajtja	
			III.3.2.2 Llogaria e fitimeve/humbjeve reale nga mbajtja	B.1032 Ndryshimet e vlerës neto për shkak të fitimeve/humbjeve reale nga mbajtja	
Bilancet	IV. Bilancet	IV.1 Bilanci fillestar		B.90 Vlera neto	Vlera kombëtare
		IV.2 Ndryshimet në bilanc		B.10 Ndryshimet e vlerës neto, total	Ndryshimet e vlerës kombëtare
		IV.3 Bilanci mbyllës		B.90 Vlera neto	Vlera kombëtare
Llogaritë e transaksioneve	0. Llogaria e mallrave dhe shërbimeve				

Llogaria e pjesës së botës (llogaria e transaksioneve të jashtme)

Grupi	Llogaria	Nën-llogaria	Nën-nën-llogaria	Zëri baraspeshues	Agregati kryesor
Llogaria rrjedhëse	V. Llogaria e pjesës së botës — Llogaria e jashtme e mallrave dhe shërbimeve (V.I)			B.11 Bilanci i jashtëm i mallrave dhe shërbimeve	Bilanci i jashtëm i mallrave dhe shërbimeve
	V.II Llogaria e jashtme e të ardhurave primare dhe transfertave rrjedhëse			B.12 Bilanci i jashtëm rrjedhës	Bilanci i jashtëm rrjedhës
Llogaritë e akumulimit	V.III Llogaritë e jashtme të akumulimit	V.III.1 Llogaria e kapitalit	V.III.1.1 Llogaria e ndryshimit të vlerës neto për shkak të bilancit të jashtëm rrjedhës dhe transfertave kapitale	B.101 Ndryshimet e vlerës neto për shkak të bilancit të jashtëm rrjedhës dhe transfertave kapitale	
			V.III.1.2 Llogaria e blerjes së aktiveve jofinanciare	B.9 Huadhënie/huamarrje neto	
		V.III.2 Llogaria financiare		B.9F Huadhënie/huamarrje neto	Huadhënie/huamarrje neto
		V.III.3 Llogaria e ndryshimeve të tjera në aktive	V.III.3.1 Llogaria e ndryshimeve të tjera në vëllimin e aktiveve	B.102 Ndryshimet e vlerës neto, për shkak të ndryshimeve të tjera në vëllimin e aktiveve	
			V.III.3.2 Llogaritë e rivlerësimit	B.103 Ndryshimet e vlerës neto, për shkak të fitimeve/humbjeve nominale nga mbajtja	
Bilancet	V.IV Llogaria e aktiveve dhe detyrimeve të jashtme	V.IV.1 Bilanci fillestar		B.90 Vlera neto	Pozicioni financiar neto i jashtëm
		V.IV.2 Ndryshimet në bilanc		B.10 Ndryshimet e vlerës neto	
		V.IV.3 Bilanci mbyllës		B.90 Vlera neto	Pozicioni financiar neto i jashtëm

(18) paragrafi 9.61 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'9.61 Megjithatë, vetitë analitike të tabelave produkt-me-produkt dhe tabelave degë-me-degë nuk ndryshojnë ndjeshëm. Dallimet mes tabelave produkt-me-produkt dhe tabelave degë-me-degë shkaktohen nga ekzistenca e një sasie përgjithësisht të kufizuar prodhimi dytësor. Në praktikë, përdorimet analitike të tabelave input-output supozojnë në mënyrë implicite një teknologji dege, pavarësisht se si janë hartuar fillimisht tabelat. Për më tepër, në praktikë, çdo tabelë produkt-me-produkt është një tabelë degë-me-degë e manipuluar, pasi ende përmban të gjitha karakteristikat KAU dhe të ndërmarrjes së tabelave të burimeve dhe përdorimeve.';

(19) paragrafi 10.27 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'10.27 Për transaksionet në shërbime, shpesh është më e vështirë të specifikohen karakteristikat që përcaktojnë njësitë fizike, dhe mund të lindin mendime të ndryshme lidhur me kriteret që duhen përdorur. Kjo vështirësi mund të prekë degë të rëndësishme si shërbimet e ndërmjetësimit financiar, tregtia me shumicë dhe pakicë, shërbimet për ndërmarrjet, arsimi, kërkimi dhe zhvillimi, shëndetësia ose argëtimi. Zgjedhja e njësive fizike për këto aktivitete paraqitet në Manualin mbi matjet e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare (*).

(*) Eurostat, Manuali mbi matjet e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare, 2016.';

(20) në paragrafin 10.56, shënimi i dytë në fund të faqes zëvendësohet me tekstin si vijon:

'Eurostat-OECD, Manuali metodologjik Eurostat-OECD mbi paritetet e fuqisë blerëse, 2012.';

(21) në paragrafin 14.06, fjalia e dytë zëvendësohet me tekstin si vijon:

'Llogaritjet e FISIM-it përqendrohen te nën-sektorët S.122 dhe S.125; sipas konventës, FISIM nuk llogaritet për bankën qendrore (shih paragrafin 14.16).';

(22) në paragrafin 15.27, teksti 'Ky aktiv (kategoria AN.222) njihet vetëm nëse vlera e tij, përfitimet për mbajtësin përtej vlerës që i takon çështjeve (issues), është e realizueshme nëpërmjet transferimit të aktivit.' zëvendësohet me tekstin si vijon:

'Ky aktiv (kategoria AN.222) njihet vetëm nëse vlera e tij, përfitimet për mbajtësin përtej vlerës që i takon emetuesit (issuer), është e realizueshme nëpërmjet transferimit të aktivit.';

(23) në paragrafin 15.31, tabela 15.4 zëvendësohet me tekstin si vijon:

Tabela 15.4

Regjistrimi i përdorimit dhe blerjes së aktiveve jofinanciare, sipas llojit të transaksionit dhe rrjedhës

Lloji i transaksionit / rrjedha tjetër ekonomike	Lloji i përdorimit/blerjes dhe lloji i aktivit dhe lloji i pagesës
Konsum i ndërmjetëm	Qira operative e aktiveve të prodhuara, p.sh. makineri dhe të drejta të pronësisë intelektuale Pagesa të rregullta nga korporatat për furnizimin me ujë Shërbime FISIM lidhur me sigurimin e një qiraje financiare
Konsum i kapitalit fiks	Vetëm për aktivet e prodhuara, dhe për pronarin ekonomik
Shpenzim për konsum final	Qira operative e mallrave të qëndrueshme konsumi Blerje e mallrave të qëndrueshme konsumi, përfshirë kur financohet nëpërmjet qiraje financiare, ose nëpërmjet marrëveshjes së qirasë me blerje (hire purchase)
Blerje e aktiveve jofinanciare	
Formim i kapitalit fiks	Blerje e aktiveve të prodhuara, përfshirë kur financohet nëpërmjet qiraje financiare
Blerje e burimeve natyrore	Blerje e një burimi natyror, përfshirë të drejtën e përdorimit deri në shterim Blerje e së drejtës për të përdorur një burim natyror për një periudhë të zgjatur, p.sh. kuotë peshkimi
Blerje e aktiveve të tjera jo të prodhuara	Marrëveshje kohë-ndarjeje (time-share) të transferueshme Blerje e një kontrate të transferueshme te një palë e tretë Kontrata për prodhim të ardhshëm, për shembull kontrata me futbollistë dhe shkrimtarë

Lloji i transaksionit / rrjedha tjetër ekonomike	**Lloji i përdorimit/blerjes dhe lloji i aktivit dhe lloji i pagesës**
Pagesë si e ardhur prone: qira	Qira burimi, d.m.th. pagesë për përdorim afatshkurtër të një burimi natyror Pagesa të rregullta për të drejtën e nxjerrjes së ujit Qira financiare, d.m.th. blerje e një aktivi jofinanciar e financuar njëkohësisht nga një hua
Transfertë e të ardhurave	Leje të lëshuara nga qeveria për të ushtruar një aktivitet specifik që nuk varet nga kritere kualifikuese, ose me një tarifë joproporcionale krahasuar me kostot e administrimit të skemës së lejeve Leje emetimi të lëshuara nga qeveria për të kontrolluar emetimet totale
Tatime të tjera mbi prodhimin	
Transaksion financiar: hua	Qira financiare, d.m.th. blerje e një aktivi jofinanciar e financuar njëkohësisht nga një hua
Ndryshim tjetër në vëllimin e aktiveve	Shterim i burimeve natyrore nga pronari Prerje, peshkim ose gjueti e paligjshme (marrje pa kompensim e aktiveve të kultivuara ose burimeve natyrore)
Ndryshim në çmimin e aktiveve	Skadim i kontratave, licencave dhe lejeve të regjistruara si aktive'

(24) paragrafi 15.32 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'15.32 Kur qeveritë kufizojnë numrin e makinave të autorizuara për të operuar si taksi ose kufizojnë numrin e kazinove nëpërmjet lëshimit të lejeve, për shembull, ato krijojnë në fakt fitime monopoli për operatorët e miratuar dhe rikuperojnë një pjesë të fitimeve si tarifë. Këto tarifa regjistrohen si tatime të tjera mbi prodhimin. Ky parim zbatohet për të gjitha rastet kur qeveria lëshon leje për të kufizuar numrin e njësive që operojnë në një fushë të caktuar, ku kufiri caktohet në mënyrë arbitrare dhe nuk varet vetëm nga kriteret kualifikuese.';

(25) paragrafi 15.35 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'15.35 Leja për të ushtruar aktivitete specifike si aktiv shfaqet për herë të parë në llogarinë e ndryshimeve të tjera në vëllimin e aktiveve. Ndryshimet në vlerë, si rritje ashtu edhe rënie, regjistrohen në llogarinë e rivlerësimit të blerësit.';

(26) në paragrafin 16.67, tabela 16.1 zëvendësohet me tabelën si vijon (shih faqen tjetër):

[Tabela 16.1 — 'Sigurimi jo-jetë' — shih faqen e formatuar në orientim horizontal (landscape) më poshtë *[Tabela 16.1 — 'Sigurimi jo-jetë' — e paraqitur në orientim horizontal më poshtë]*

(27) paragrafi 17.148 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'17.148 Nëse qeveria merr përsipër përgjegjësinë për sigurimin e pensioneve për punonjësit e një njësie joqeveritare nëpërmjet një transaksioni të shprehur, çdo pagesë nga njësia joqeveritare duhet të regjistrohet si kontribute shoqërore të parapaguara (F.89). Ka një diskutim të mëtejshëm për këtë lloj marrëveshjeje në paragrafët 20.273 deri 20.275.';

(28) paragrafi 17.165 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'17.165 Norma e skontimit e zbatuar për vlerësimet e përfitimeve të ardhshme të pensionit në rastin e të drejtave të përllogaritura deri më sot është një nga supozimet më të rëndësishme që duhen bërë në modelimin e skemave të pensioneve, pasi ndikimi i tij i akumuluar gjatë shumë dekadash mund të jetë shumë i madh. Norma e skontimit nga një qasje e zgjedhur mund të ndryshojë me kohën, gjë që do të çonte në rivlerësime në llogaritë.';

(29) në paragrafin 18.26, shënimi në fund të faqes zëvendësohet me tekstin si vijon:

'Kombet e Bashkuara, Statistikat ndërkombëtare të tregtisë së mallrave: Koncepte dhe përkufizime, 2010.';

(30) në paragrafët 20.57, 20.63 dhe 20.65, fjalët '(duke përjashtuar sigurimet shoqërore)' zëvendësohen me fjalët '(duke përjashtuar fondet e sigurimeve shoqërore)';

(31) në paragrafin 20.76, tabela zëvendësohet me tekstin si vijon:

Të ardhura totale	=	tatimet totale	D.2 + D.5 + D.91
	+	kontribute shoqërore neto	D.61

	+	shitje totale mallrash dhe shërbimesh	P.11 + P.12 + P.131
	+	të ardhura të tjera rrjedhëse	D.39 + D.4 + D.7
	+	të ardhura të tjera kapitale	D.92 + D.99'

(32) paragrafi 20.77 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'20.77 Tatimet totale përfshijnë tatimet mbi prodhimin dhe importet (D.2), tatimet rrjedhëse mbi të ardhurat dhe pasurinë, etj. (D.5) dhe tatimet kapitale (D.91). Kontributet shoqërore neto përbëhen nga kontributet shoqërore aktuale (kontributet shoqërore aktuale të punëdhënësve (D.611) dhe kontributet shoqërore aktuale të familjeve (D.613)), kontributet shoqërore të nënkuptuara të punëdhënësve (D.612) dhe shtesat e kontributeve shoqërore të familjeve (D.614) minus tarifat e shërbimit të skemës së sigurimit shoqëror (D.61SC).';

(33) në paragrafin 20.84, kutia 20.1 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'Kutia 20.1 — Nga kuadri qendror i ESA-s te transaksionet dhe agregatët e Statistikave të Financave Qeveritare (GFS)

Burimet ESA		**ESA GFS Të ardhurat**
P.1	Prodhimi (Output), nga i cili:	
	Prodhimi i tregut (P.11)	Shitje mallrash dhe shërbimesh
	Prodhimi për përdorim përfundimtar të vet (P.12)	Shitje mallrash dhe shërbimesh
	Prodhimi jo-tregtar (P.13), nga i cili:	
	— Pagesa për prodhimin jo-tregtar (P.131)	Shitje mallrash dhe shërbimesh
	— Prodhim jo-tregtar, tjetër (P.132)	Nuk llogaritet në të ardhurat totale
D.2	Tatime mbi prodhimin dhe importet (të arkëtueshme)	Tatimet totale
D.3	Subvencione (të arkëtueshme)	Të ardhura të tjera rrjedhëse
D.4	Të ardhura prone	Të ardhura të tjera rrjedhëse
D.5	Tatime rrjedhëse mbi të ardhurat dhe pasurinë	Tatimet totale
D.61	Kontribute shoqërore neto	Kontribute shoqërore neto
D.7	Transferta të tjera rrjedhëse	Të ardhura të tjera rrjedhëse
D.91r	Tatime kapitale (të arkëtueshme)	Tatimet totale
D.92r	Grante investimi (të arkëtueshme)	Të ardhura të tjera kapitale
D.99r	Transferta të tjera kapitale (të arkëtueshme)	Të ardhura të tjera kapitale

ESA Përdorimet dhe transaksionet kapitale		**ESA GFS Shpenzimet**
P.2	Konsum i ndërmjetëm	Konsum i ndërmjetëm
D.1	Shpërblim punonjësish	Shpërblim punonjësish
D.2	Tatime mbi prodhimin dhe importet (të pagueshme)	Shpenzime të tjera rrjedhëse
D.3	Subvencione (të pagueshme)	Subvencione
D.41	Interes	Interes
D.4	Të ardhura prone (duke përjashtuar D.41)	Shpenzime të tjera rrjedhëse
D.5	Tatime rrjedhëse mbi të ardhurat	Shpenzime të tjera rrjedhëse
D.62	Përfitime shoqërore të ndryshme nga transfertat sociale në natyrë	Përfitime shoqërore të ndryshme nga transfertat sociale në natyrë
D.632	Transferta sociale në natyrë nëpërmjet prodhuesve të tregut	Transferta sociale në natyrë nëpërmjet prodhuesve të tregut
D.7	Transferta të tjera rrjedhëse	Shpenzime të tjera rrjedhëse
D.8	Rregullim për ndryshimin në të drejtat e pensionit	Shpenzime të tjera rrjedhëse

ESA Përdorimet dhe transaksionet kapitale		ESA GFS Shpenzimet
P.31	Shpenzim për konsum individual mbi prodhimin e tregut	Transferta sociale në natyrë nëpërmjet prodhuesve të tregut
P.31	Shpenzim për konsum individual mbi prodhimin jo-tregtar	Nuk llogaritet në shpenzimet totale
P.32	Shpenzim për konsum kolektiv	Nuk llogaritet në shpenzimet totale
P.5	Formim bruto kapitali	Shpenzime kapitale
NP	Blerje minus disponim i aktiveve jo të prodhuara	Shpenzime kapitale
D.92p	Grant investimi (i pagueshëm)	Shpenzime kapitale
D.99p	Transferta të tjera kapitale (të pagueshme)	Shpenzime kapitale

Në kuadrin qendror të ESA, huadhënia/huamarrja neto (B.9) është zëri baraspeshues i llogarisë së kapitalit. Zëri baraspeshues i qeverisjes së përgjithshme në paraqitjen ESA GFS është identik me huadhënien/huamarrjen neto (B.9). Kjo kuti shpjegon pse.

Kuadri qendror i ESA

Llogaria e parë është llogaria e prodhimit, dhe prandaj burimi i parë i një sektori institucional në ESA është prodhimi i tij. Meqenëse shumica e shërbimeve të ofruara nga qeveria nuk shiten me çmime ekonomikisht domethënëse dhe kështu janë jo-tregtare, prodhimi i qeverisë matet, sipas konventës, si shuma e kostove të prodhimit.

Në mënyrë të ngjashme, shpenzimi për konsum final kolektiv, i përbërë nga shërbimet e ofruara komunitetit nga qeveria si shërbimet e përgjithshme, mbrojtja, siguria dhe rendi publik, maten si shuma e kostove të prodhimit. Gjithashtu, sipas konventës, shpenzimi për konsum kolektiv (P.32) është i barabartë me konsumin final aktual (P.4) të qeverisë.

Shpenzimi për konsum final individual i familjeve i ofruar drejtpërdrejt nga qeveria mbi bazë jo-tregtare matet gjithashtu me kostot e tij të prodhimit.

Si rezultat, dy lloje rrjedhash 'nënkuptohen' (imputohen) në llogaritë ESA të qeverisë:

(1) në anën e burimeve, prodhimi jo-tregtar, tjetër (P.132) i regjistruar në llogarinë e prodhimit;

(2) në anën e përdorimeve, konsumi final aktual (P.4) dhe transfertat sociale në natyrë — prodhim jo-tregtar (D.631). Ato regjistrohen në llogarinë e rishpërndarjes së të ardhurave në natyrë, dhe në llogarinë e përdorimit të të ardhurave të disponueshme të rregulluara.

Çdo rrjedhë e nënkuptuar është e barabartë me shumën e rrjedhave aktuale: kostot e prodhimit. Këto dy lloje rrjedhash të nënkuptuara, në anën e burimeve dhe në anën e përdorimeve, balancohen në sekuencën e llogarive ESA.

ESA GFS paraqitja e statistikave

Të njëjtat kategori bazë transaksionesh përdoren në paraqitjen ESA GFS, por kryesisht mbi bazën e rrjedhave aktuale monetare, për të nxjerrë të ardhurat totale dhe shpenzimet totale të qeverisë. Merret parasysh vetëm një përzgjedhje e rrjedhave të nënkuptuara: kontributet shoqërore të nënkuptuara dhe transfertat kapitale në natyrë.

Duke eliminuar nga ana e burimeve prodhimin jo-tregtar (P.132) për të marrë të ardhurat totale, dhe duke eliminuar nga ana e përdorimeve konsumin final aktual (P.4=P.32) dhe transfertat sociale në natyrë — prodhim jo-tregtar (D.631) për të marrë shpenzimet totale, rezulton në të njëjtin zë baraspeshues: huadhënia/huamarrja neto (B.9).

Transfertat e vetme sociale në natyrë që llogariten në agregatin GFS të shpenzimeve totale të qeverisë janë transfertat sociale në natyrë të ofruara familjeve nëpërmjet prodhuesve të tregut (D.632), pasi ato i nënshtrohen pagesave reale nga njësitë qeveritare. Këto transaksione duhet gjithashtu të shtohen te shuma e kostove të prodhimit (e barabartë me prodhimin jo-tregtar, tjetër — P.132) për të marrë shpenzimin për konsum final të qeverisjes së përgjithshme.

P.3 = P.132 + D.632'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tabela 16.1

Sigurimi jo-jetë

Përdorime (Uses)										Burime (Resources)									
			S.1	S.15	S.14	S.13	S.12	S.11		S.11	S.12	S.13	S.14	S.15	S.1				
Total	Hyrjet korresponduese — Llog. e mallrave/shërb.	Hyrjet korresponduese — Pjesa e botës	Total ekonomia	NPISH-të	Familjet	Qeverisja e përgjithshme	Korporata financiare	Korporata jofinanciare	Kodi	Korporata jofinanciare	Korporata financiare	Qeverisja e përgjithshme	Familjet	NPISH-të	Total ekonomia	Pjesa e botës	Llog. mallrave/shërb.	Total	
Llogaria e jashtme (External account)																			
0		0							P.62	**Eksporte shërbimesh**								0	0
0	0								P.72	**Importe shërbimesh**						0			0
Llogaria e prodhimit (Production account)																			
6	6								P.1	**Prodhimi (Output)**		6				6			6
4		0	4	0	3	0	0	1	P.2	**Konsum i ndërmjetëm**								4	4
Llogaria e shpërndarjes primare të të ardhurave																			
6			6			6			D.441	**Të ardhura prone që i takojnë mbajtësve të policave të sigurimit**	5	0	0	1	0	6	0		6
Llogaria e shpërndarjes sekondare të të ardhurave																			
44		1	43	0	31	4	0	8	D.711	**Prime neto të sigurimit jo-jetë**		44				44			44
45		0	45				45		D.721	**Dëmshpërblime sigurimi jo-jetë**	6	0	1	35	0	42	3		45
Llogaria e përdorimit të të ardhurave të disponueshme																			
2			2		2				P.3	**Shpenzim për konsum final**								2	2
Bilanci financiar (fillestar)																			
74		0	74		40	0	9	25	AF.61	**Rezerva teknike të sigurimit jo-jetë**		74				74			74
Bilanci financiar (mbyllës)																			
81		0	81	0	44	0	11	25	AF.61	**Rezerva teknike të sigurimit jo-jetë**		81				81			81
Transaksioni financiar																			
7		0	7	0	4	0	2	1	F.61	**Rezerva teknike të sigurimit jo-jetë**		7				7			7
Llogaria e rivlerësimit																			
0		0	0	0	0	0	0	0	AF.61	**Rezerva teknike të sigurimit jo-jetë**		0				0			0'

(34) paragrafi 20.90 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'20.90 Subvencionet e marra nga njësitë qeveritare përbëhen vetëm nga subvencionet e tjera mbi prodhimin. Kur merren nga njësi prodhuese që i përkasin qeverisjes së përgjithshme, subvencionet mbi produktet përfshihen në vlerësimin e prodhimit dhe shitjeve me çmime bazë.';

(35) paragrafi 20.130 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'20.130 Riblerja nga një njësi e një detyrimi regjistrohet si shlyerje e detyrimeve dhe jo si blerje aktivesh. Në mënyrë të ngjashme, në nivel nën-sektori ose sektori, blerja nga një njësi qeveritare e një detyrimi të emetuar nga një njësi tjetër e po atij nën-sektori do të paraqitet, në paraqitjen e konsoliduar, si shlyerje e detyrimit nga ai nën-sektor ose sektor.';

(36) paragrafi 20.158 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'20.158 Tatimet ose subvencionet e paguara nga një njësi qeveritare ose entitet te një tjetër nuk konsolidohen. Tatimet ose subvencionet mbi produktet nuk mund të konsolidohen në sistem sepse nuk ka sektor kundërpalë transaktori në ESA për transaksione të tilla; shumat përkatëse nuk njihen veçmas si shpenzim dhe të ardhur (përkatësisht) dhe në vend të kësaj përfshihen në, ose përjashtohen nga, vlera e konsumit të ndërmjetëm ose e shitjeve.';

(37) paragrafi 21.22 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'21.22 Vlerësimet e aktiveve me vlerë të drejtë jo vetëm që japin një pamje më të mirë të bilancit sesa vlerësimet me kosto historike, por gjithashtu gjenerojnë më shumë të dhëna mbi fitimet/humbjet nga mbajtja.';

(38) paragrafi 22.13 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'22.13 Në Coicop dallohen 15 kategori kryesore:

(a) ushqime dhe pije jo-alkoolike;
(b) pije alkoolike, duhan dhe narkotikë;
(c) veshje dhe këpucë;
(d) strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse;
(e) mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e shtëpisë;
(f) shëndetësi;
(g) transport;
(h) informacion dhe komunikim;
(i) argëtim, sport dhe kulturë;
(j) shërbime arsimore;
(k) restorante dhe shërbime akomodimi;
(l) sigurime dhe shërbime financiare;
(m) kujdes personal, mbrojtje sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme;
(n) shpenzim për konsum individual i institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve (NPISH-të); dhe
(o) shpenzim për konsum individual i qeverisjes së përgjithshme.

13 kategoritë e para përbëjnë shumën e shpenzimit total për konsum individual nga familjet. Dy të fundit identifikojnë shpenzimin për konsum individual të sektorëve NPISH dhe qeverisje e përgjithshme, d.m.th. transfertat e tyre sociale në natyrë. Së bashku, të gjitha 15 zërat përfaqësojnë konsumin final aktual nga familjet.';

(39) paragrafi 22.14 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'22.14 Shpenzimi për konsum individual i NPISH-ve dhe qeverisjes së përgjithshme ndahet në pesë nën-kategori të përbashkëta që pasqyrojnë çështje kryesore politike: strehim, shëndetësi, argëtim dhe kulturë, arsim, dhe mbrojtje sociale. Këto janë gjithashtu funksione Coicop për shpenzimin për konsum individual nga familjet; mbrojtja sociale është nën-kategori e kategorisë 13, 'kujdes personal, mbrojtje sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme'. Si rrjedhojë, Coicop tregon gjithashtu për secilën nga këto pesë nën-kategori të përbashkëta, rolin e familjeve private, qeverisë dhe NPISH-ve. Për shembull, mund të përshkruajë rolin e qeverisë në ofrimin e strehimit, shëndetësisë dhe arsimit.';

(40) paragrafi 22.16 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'22.16 Klasifikimi i shpenzimeve qeveritare sipas funksionit (COFOG) është një instrument kryesor për përshkrimin dhe analizimin e financave qeveritare. 10 divizionet kryesore të dalluara janë:

(a) shërbime të përgjithshme publike;
(b) mbrojtje;
(c) rend dhe siguri publike;
(d) çështje ekonomike;
(e) mbrojtje mjedisore;
(f) strehim dhe komoditete komunitare;
(g) shëndetësi;
(h) argëtim, kulturë dhe fe;
(i) arsim; dhe
(j) mbrojtje sociale.
Klasifikimi përdoret për të klasifikuar shpenzimin për konsum individual dhe kolektiv nga qeveria. Megjithatë, ai shërben gjithashtu për të ilustruar rolin e llojeve të tjera të shpenzimeve si subvencionet, grantet e investimit dhe përfitimet sociale, për qëllime politikash.';

(41) Kapitulli 23 ndryshohet si vijon:

(a) paragrafi 23.05 zëvendësohet me tekstin si vijon:

'23.05 Përveç COFOG dhe Coicop, klasifikimet funksionale përfshijnë gjithashtu COPNI (klasifikimi i qëllimeve të institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve) dhe COPP (klasifikimi i shpenzimeve të prodhuesve sipas qëllimit). Këto klasifikime përdoren për analizën funksionale të shpenzimeve nga korporatat, qeveria, familjet dhe institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve dhe për llogaritë satelitore funksionale.';

(b) tabela e futur nën titullin 'Transaksionet në produkte (P)' zëvendësohet me tekstin si vijon:

P.1	Prodhimi (Output)
P.11	Prodhim tregtar
P.119	Shërbime ndërmjetësimi financiar të matura tërthorazi (FISIM)
P.12	Prodhim për përdorim përfundimtar të vet
P.13	Prodhim jo-tregtar
P.131	Pagesa për prodhim jo-tregtar
P.132	Prodhim jo-tregtar, tjetër
P.2	Konsum i ndërmjetëm
P.3	Shpenzim për konsum final
P.31	Shpenzim për konsum individual
P.32	Shpenzim për konsum kolektiv
P.4	Konsum final aktual
P.41	Konsum individual aktual
P.42	Konsum kolektiv aktual
P.5	Formim bruto kapitali / P.5n formim neto kapitali
P.51g	Formim bruto i kapitalit fiks
P.511	Blerje minus disponime të aktiveve fikse
P.5111	Blerje të aktiveve fikse të reja
P.5112	Blerje të aktiveve fikse ekzistuese
P.5113	Disponime të aktiveve fikse ekzistuese
P.512	Kosto të transferimit të pronësisë mbi aktive jo të prodhuara
P.51c	Konsum i kapitalit fiks (–)
P.51c1	Konsum i kapitalit fiks mbi tepricën bruto të veprimtarisë (–)
P.51c2	Konsum i kapitalit fiks mbi të ardhurat e përziera bruto (–)
P.51n	Formim neto i kapitalit fiks
P.52	Ndryshime në inventar
P.53	Blerje minus disponime të sendeve me vlerë

P.6	Eksporte mallrash dhe shërbimesh
P.61	Eksporte mallrash
P.62	Eksporte shërbimesh
P.7	Importe mallrash dhe shërbimesh
P.71	Importe mallrash
P.72	Importe shërbimesh'

(c) teksti dhe tabela e futur nën titullin 'Mallra të qëndrueshëm konsumi' zëvendësohen me tekstin si vijon:

'Mallrat e qëndrueshëm konsumi kodifikohen duke përdorur X si parashtesë plus DHHCE (shpenzimi i qëndrueshëm i konsumit të familjeve) plus një shifër shtesë për nën-grupet dhe dy shifra për zërat.

Kodet SLLK (SNA)

XDHHCE1	Mobilje dhe pajisje shtëpiake
XDHHCE11	Mobilje dhe pajisje mobiluese
XDHHCE12	Qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje
XDHHCE13	Pajisje të mëdha shtëpiake, elektrike ose jo
